



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 2, datë 06.02.2024


**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL**

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira, që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	KRITERET	SHKALLA E VLERËSIMIT
1	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpinë me një numër të madh pjesëtarësh të familjes me një sipërfaqe të banuar nën normat e strehimit.	0/20
2	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpi me një numër të madh pjesëtarësh të familjes ku banesa ka kushte jo të mira sanitare ose rrezikon shembjen	0/10
3	<b>Familjet me nevoja të veçanta në një nga kategoritë e mëposhtme:</b>	0/20
	a. Personat të moshuar në moshë pensioni dhe që nuk mund të përzgjidhen për të përfituar strehim nga institucionet sociale të kujdesit publik.	0/5
	b. Individët me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e personit të verbër dhe që i përkasin grupit të parë, invalidët si për shembull paraplegjikët, invalidët e punës ose të luftës së dytë botërore.	0/10
	c. Individët me statusin e jetimit, nga momenti që ata braktisin jetimoren ose qendrat e përkujdesjes deri në moshën 30 vjeçare	0/5
4	<b>Familjet në vështirësi ekonomike në një nga kategoritë e mëposhtme:</b>	0/10
	a. Familjet me një prind të vetëm me fëmijën në ngarkim ku kryefamiljare është i/e ve ose i/e divorcuar ose familje me më shumë se 4 fëmijë	0/5
	b. Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0/3
	c. Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	0/2
5	<b>Familjet e përshtatshme për ndihmë për strehim në një prej kategorive të mëposhtme:</b>	0/10
	a. Familjet e reja, të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	0/3
	b. Familjet e emigranti i rikthyer, punëtor emigrant dhe azilkërkuessit; refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës	0/2

	c. Familje të komunitetit rom dhe egjiptian ose Familje që përfitojnë nga Ligji nr.82/2012 “Për miratimin e Aktit Normativ nr.3, datë 01.08.2012 “Për lirimimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarë të pastrehë banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar””	0/5
<b>6</b>	<b>Kategoritë e të ardhurave</b>	<b>0/30</b>
	<p>a. Kufiri maksimal i të ardhurave deri 75% e të ardhurave mesatare kombëtare</p> <p>Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (65,896–70,895) Lekë  Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (76,501– 77,418) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (87,501– 90,592) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (100,001–101,411) Lekë</p>	0/5
	<p>b. Niveli mesatar i të ardhurave</p> <p>Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (58,593 –65,895) Lekë  Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (75,501–76,500) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (85,501–87,500) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (96,501–100,000) Lekë</p>	0/10
	<p>c. Niveli minimal i të ardhurave</p> <p>Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (38,646 – 58,592) Lekë  Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (74,390 – 75.500) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (82,551–85.500) Lekë  Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (93,551–96.500) Lekë</p>	

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2024**





BASHKIA DURRE  
15.02.24 Nr. 1492/B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRE

Nr. 97/2 Prot.

Durrës, më 15.02.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRE**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRE**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.2 datë 06.02.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

